



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 164

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 26 shtator 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 335, datë 23.9.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19359
Dekret i Presidentit nr. 336, datë 23.9.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19359
Dekret i Presidentit nr. 337, datë 23.9.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19359
Dekret i Presidentit nr. 338, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19360
Dekret i Presidentit nr. 339, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19360
Dekret i Presidentit nr. 340, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19360
Dekret i Presidentit nr. 341, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19360
Dekret i Presidentit nr. 342, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19361
Dekret i Presidentit nr. 343, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19361
Dekret i Presidentit nr. 344, datë 23.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 19361
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 583, datë 25.9.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 175, datë 4.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”..... 19362
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 25.9.2024	Për lirim nga detyra të drejtorit të Cirkut Kombëtar..... 19362

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 588, datë 25.9.2024	Për mbylljen e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “ <i>Wisdom</i> ”	19362
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 715, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.	19363
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 716, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Danimarkës.	19364
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 717, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Çekisë.....	19364
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 718, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë.....	19366
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 719, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	19369
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 720, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës.....	19371
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 721, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë.....	19373
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 722, datë 18.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	19375
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.9.2024	Faik Toshkëzi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 4607/09</i>).....	19377
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.9.2024	Ndreka j sh.p.k. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 57941/18</i>).....	19380
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 195, datë 23.9.2024	Për delegim kompetencash.....	19381
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Shpëtim Dauti.....	19382



DEKRET
Nr. 335, datë 23.9.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aurilda Fatmir Gashi (Dunga)
2. Arla Klajd Gashi
3. Arlis Klajd Gashi
4. Sara Arben Bejko

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 336, datë 23.9.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, mepropozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Endi Mentor Sykja
2. Bledar Hamit Hasa

3. Eni Mirush Bejko
4. Edlira Habip Imeraj (Zeneli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 337, datë 23.9.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Endri Zamir Mara
2. Ejon Fatmir Duka
3. Blerina Tefik Lapi (Skënderaj)
4. Hristiana Joani Kaçota
5. Elis Sherif Beqiri
6. Olik Elis Beqiri
7. Olent Elis Beqiri
8. Koan Elis Beqiri
9. Alma Elez Kaçota (Jusuifi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 338, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Flurim Emin Kadriaj
2. Skender Qazim Ahmataj
3. Mattia Lorenzo Petronelli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 339, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ganimete Amdi Babuna (Hoxha)
2. Arta Agron Bunjaku

3. Eron Shpejtim Berisha
4. Kadri Ramiz Rakaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 340, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Hasan Riza Neza (Nezaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 341, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr.



113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Adelina Haki Lika (Jashanica)
2. Laura Giuseppe Sturaro

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 342, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Lirim Feriz Idrizaj
2. Zaher Hasan Douri
3. Shkendie Nebi Hodaj (Çoçaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 343, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Elza Rexhë Memaj (Morina)
2. Argjenta Nuhi Shërmadhi (Matoshi)
3. Jeton Zeqir Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 344, datë 23.9.2024

PËR DHËNIE TË SHETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Valeria Victor Antonio Murillo Luna



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 583, datë 25.9.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 175, DATË 4.4.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E
ANËTARËVE TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 175, datë 4.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, fjalët “... përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ...,” zëvendësohen me “... përfaqësues i Ministrisë së Financave ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 584, datë 25.9.2024

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Laid Ymeri, drejtor i Cirkut Kombëtar, lirohet nga kjo detyrë.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 588, datë 25.9.2024

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
KOLEGJIT UNIVERSITAR “WISDOM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “I”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbyllet e veprimtarisë së kolegjit universitar “Wisdom”, i cili e ka ushtruar veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji universitar “Wisdom” ka këto detyrime:
a) të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore, për vitin akademik 2023–2024, deri në përfundimin e tij, në të gjitha programet e studimit të ofruara;

b) të përgatisë dosjen për çdo student që nuk ka përfunduar programin përkatës të studimit, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë, që plotëson kriteret ligjore për transferimin e studimeve dhe t’ia vëre atë në dispozicion vetë studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

c) të kthejë pagesat e kryera nga çdo student për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur që mund të ketë ndaj studentit;



ç) të dorëzojë dokumentacionin ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon dhe mbi bazën e të cilit ka zhvilluar veprimtarinë e tij akademike dhe kërkimore-shkencore në strukturat përgjegjëse, në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

d) të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave, të parashikuara në këtë vendim.

dh) të vendosë në dispozicion personel akademik dhe administrativ të nevojshëm deri në përfundimin e procesit për mbylljen e tij, sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim.

3. Vula e kolegjit universitar “*Wisdom*” asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e kolegjit universitar “*Wisdom*”, në zbatim të këtij vendimi, përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/personit juridik që e përfaqëson.

5. Institucionet e arsimit të lartë pranojnë deri më datë 20.11.2024, aplikimet për transferimin e studentëve të kolegjit universitar “*Wisdom*”, për vitin akademik 2024–2025, në programe të njëjta apo të ngjashme studimi, kur plotësojnë kriteret ligjore.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kolegji universitar “*Wisdom*”/personi juridik “*Wisdom*” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR

Nr. 715, datë 18.9.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3	*bashki/fshat /provincë
1	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*	
2	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*	
3	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	West-Rügen*	
4	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*	
5	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Oldenburg-Land*	
6	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Bad Bentheim*	
7	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*	
8	Sachsen-Anhalt	Saalekreis	Leuna*	

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve,



për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 654, datë 23.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 716, datë 18.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E DANIMARKËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Danimarkës, sipas tabelës së mëposhtme:

Faqe | 19364

*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Veterinary Inspection Unit East	Guldborgsund*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 717, datë 18.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E ÇEKISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:



a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidëve.

Nga shteti i Çekisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Karlovarský	Sokolov*	
Karlovarský	Karlovy Vary*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një

programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

d) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;



v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 697, datë 12.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Çekisë”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 718, datë 18.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Lazio	Roma*	
Lazio	Rieti*	
Liguria	Genova*	
Liguria	Savona*	
Liguria	La Spezia	Varese Ligure*
Piemonte	Alessandria*	
Piemonte	Novara	Castellazzo Novarese*
Piemonte	Novara	Casalvolone*
Piemonte	Novara	Treccate*
Piemonte	Novara	Novara*
Piemonte	Novara	San Pietro Mosezzo*
Piemonte	Novara	Vinzaglio*
Piemonte	Torino*	
Piemonte	Asti*	
Piemonte	Vercelli	Lignana*
Sardegna	Nuoro*	
Sardegna	Sassari*	
Campania	Salerno	Casaleto Spartano*
Campania	Salerno	Casalbuono*
Campania	Salerno	Buonabitacolo*
Calabria	Reggio Di Calabria*	
Lombardia	Pavia*	
Lombardia	Milano	Besate*
Lombardia	Milano	Vernate*
Lombardia	Lodi	Sant' Angelo Lodigiano*
Lombardia	Lodi	Marudo*
Lombardia	Lodi	Borghetto Lodigiano*
Lombardia	Lodi	Castiraga Vidardo*
Emilia-Romagna	Piacenza*	
Emilia-Romagna	Parma*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të



mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejneri të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialin biologjik dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënproduktet e tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Italisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitullin 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1



ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin, me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në

një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 695, datë 12.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 719, datë 18.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybots'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Cherkasy	Smilians'kyi*	
Cherkasy	Cherkas'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Baryshivs'kyi*	

Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Iahotyns'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novomyrhorods'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'kyi*	
Kirovohrad	Oleksandriis'kyi*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Kirovohrad	Znamians'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolavs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Berezhneuvats'kyi*	
Mykolayiv	Kryvoozers'kyi*	
Mykolayiv	Vradivs'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Poltava	Kobeliats'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Kolomyis'kyi*	
Sumy	Konotops'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Vinnitsya	Iampil's'kyi*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të



paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar, me rezultate të favorshme, një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë



që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 696, datë 12.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 720, datë 18.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E ZVICRËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Zvicrës sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Basel-Stadt	Riehen	Riehen*
Basel-Landschaft	Liestal	Bubendorf*
Basel-Landschaft	Sissach	Zunzgen*



Basel-Landschaft	Waldenburg	Arboldswil*
Vaud	Pays-d'Enhaut	Saint-Légier-la-Chiésaz*
Jura	Porrentruy	Buix*
Jura	Porrentruy	Bressaucourt*
Jura	Porrentruy	Courgenay*
Jura	Porrentruy	Courtedoux*
Jura	Porrentruy	Damphreux*
Jura	Porrentruy	Chevenez*
Jura	Porrentruy	Fregécourt*
Jura	Les Franches-Montagnes	Le Noirmont*
Jura	Les Franches-Montagnes	Soubey*
Thurgau	Kreuzlingen	Kemmental*
Solothurn	Dorneck	Metzerlen-Mariastein*
Solothurn	Dorneck	Rodersdorf*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13. Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën

14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14. deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6. dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28



dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9. dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 674, datë 6.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 721, datë 18.9.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidëve.

Nga shteti i Italisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitruapat ndaj



virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitropa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 722, datë 18.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga fajja zyrtare e OIE-s dhe të ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Dolnośląskie*		
Lubelskie*		
Lubuskie*		
Małopolskie*		
Mazowieckie*		
Opolskie*		
Podkarpackie*		
Podlaskie*		
Pomorskie*		
Kujawsko-Pomorskie	Chelmno	Chelmno (rural)*
Kujawsko-Pomorskie	Grudziądz	Łasin*
Warmińsko-Mazurskie*		
Wielkopolskie*		
Zachodniopomorskie*		
Świętokrzyskie*		

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të përfshirë nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose në nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.



2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar, për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar, për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**



a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 628, datë 16.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajës Afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË VENDIM

Kërkesa nr. 4607/09
Faik TOSHKËZI
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 2 korrik 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar*,

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 4607/09) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) më 13 janar 2009, nga një shtetas shqiptar, z. Faik Toshkëzi (kërkuesi), lindur më 1965 dhe banues në Tiranë;

vendimin për të njoftuar mbi ankesën sipas nenit 6§1 – në lidhje me kohëzgjatjen e moszbatimit të vendimit përfundimtar të gjykatës – qeverinë shqiptare (qeveria), fillimisht e përfaqësuar nga Agjenti i saj znj. A. Hicka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës; vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me kohëzgjatjen e ekzekutimit të një vendimi të brendshëm.

2. Më 20 mars 1995, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave Lushnjë (Komisioni) rrëzoi kërkesën e vëllait të kërkuesit për njohjen dhe rikthimin e pronës së gjyshit të tyre, me arsyetimin se prona në fjalë ishte tokë bujqësore.

3. Vëllai i kërkuesit e kundërshtoi vendimin dhe më 16 janar 1996, Gjykata e Rrethit Lushnjë (Gjykata e Rrethit) njohu të drejtën ndaj një prone të kërkuesit dhe të trashëgimtarëve të tjerë të gjyshit të kërkuesit, dhe urdhëroi Komisionin t'i njihje si bashkëpronarë të një sipërfaqe toke me përmasat 40,000 metra katrorë (m²) në Golem, Kavajë. Procedurat u mbështetën në ligjin nr. 7698/1993, “Për rikthimin dhe kompensimin e pronave”, edhe



pse nuk u mor asnjë vendim, në lidhje me mënyrën ekzakte të rikthimit ose kompensimit të pronës. Më 7 qershor 1996, vendimi i Gjykatës së Rrethit u bë përfundimtar.

4. Më 30 prill 2002, Gjykata e Rrethit lëshoi urdhërekzekutimin për vendimin e saj të vitit 1996. Kërkuesi i kërkoj zyrës së përmbartimit që ta zbatonte urdhrin me anë të Zyrës së Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme, dhe me anë të Komisionit. Më 26 shtator 2002, përmbartuesi i ndërpreu procedurat e ekzekutimit pasi titulli i pretenduar nuk mund të regjistrohej në Regjistrin e Tokave.

5. Më 1 nëntor 2002, Gjykata e Rrethit pranoi pjesërisht padinë e kërkuetit ndaj zyrës së përmbartimit. Ajo vendosi se vendimi i vitit 1966 nuk parashikonte rikthimin e tokës në fjalë, për këtë arsye kjo e fundit nuk mund të regjistrohej në Regjistrin e Tokës në emër të kërkuetit dhe të trashëgimtarëve të tjerë. Sidoqoftë, Gjykata e Rrethit e pranoi padinë për pjesën që kishte të bënte me procedurat ekzekutuese për njohjen e të drejtës së tyre ndaj tokës dhe e urdhëroi përmbartuesin që të vepronte sipas këtij vendimi.

6. Më 7 prill 2004, zyra e përmbartimit rrëzoi një kërkesë tjetër të kërkuetit, bërë në një datë të pacaktuar, me arsyetimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit nuk ishte i zbatueshëm. Kërkuesi nuk bëri ankesë ndaj këtij vendimi.

7. As kërkuesi dhe as trashëgimtarët e tjerë nuk kanë paraqitur kërkesa për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të vitit 1996, as pranë Komisionit dhe as pranë institucioneve të tjera të linjës, Agjencia për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (ARKP) dhe Agjencia për Trajtimin e Pronës (ATP), sipas parashikimit në ligjin nr. 9235/2004 dhe ligjin nr. 133/2015.

8. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2004, kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë ngritën një padi civile sipas së cilës kërkonin anulimin e privatizimit të një fabrike tullash, të ndërtuar pjesërisht në sipërfaqen e tokës në fjalë. Më 28 tetor 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi padinë, duke konstatuar se paditësit nuk kishin argument juridik, pasi ata nuk kishin titull pronësie ndaj tokës. Gjykata argumentoi se nuk ekzistonte asnjë vendim nga Komisioni për rikthimin e tokës tek paditësit. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë më 15 mars dhe 23 dhjetor 2005, respektivisht.

9. Më 13 nëntor 2011, Gjykata e Rrethit rrëzoi kërkesën për interpretimin e vendimit të saj të vitit 1996, sipas së cilit kërkohej njohja e titullit të pronësisë ndaj sipërfaqes prej 40,000m² dhe/ose të drejtën e trashëgimtarëve për të qenë të parët për një vendimmarrje, duke konstatuar se vendimi i vitit 1996 nuk i adresonte këto problematika. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë më 4 dhjetor 2012 dhe 15 tetor 2015, respektivisht.

10. Sipas palëve, nuk ka pasur zhvillime të reja në këtë çështje pas këtij momenti.

LEGJISLACIONI PËRKATËS I BREND-SHËM

11. Legjislacioni përkatës i brendshëm, në lidhje me rikthimin dhe kompensimin e pronave, përshkruhet në detaje, *inter alia*, në vendimet *Gjonbocari dhe të Tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 10508/02, §§ 36–43, 23 tetor 2007) dhe *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 604/07 dhe 3 të tjerë, §§ 23–53, 31 korrik 2012).

12. Një përmbledhje e legjislacionit dhe praktikës përkatëse të brendshme, në lidhje me ligjin nr. 133/2015, të datës 5 dhjetor 2015, për Trajtimin e Pronës dhe Finalizimin e Procesit të Kompensimit të Pronave (Ligji i Pronave 2015) paraqitet në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 29026/06 dhe 11 të tjerë, §§ 29–109, 17 mars 2020).

VLERËSIMI I GJYKATËS

13. Kërkuesi u ankua mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës për kohëzgjatjen e zbatimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 16 janar 1996, me pretendimin se deri në atë datë Komisioni nuk kishte lëshuar ndonjë vendim për çështjen e tij.

14. Qeveria parashtroi se në mënyrë që të jepej një vendim përfundimtar për kërkuetin ndaj të drejtave të tij të njohura të pronësisë, ai do të duhej të niste procedura administrative pranë Komisionit. Më pas, Komisioni do të gjykonte nëse do të vendoste për rikthimin e tokës së tij plotësisht ose pjesërisht, ose për çdo formë tjetër kompensimi sipas parashikimit të ligjit. Gjykata argumentoi se kërkuesi nuk kishte ndjekur procedurën e duhur juridike për zbatimin e vendimit në fjalë.

15. Kërkuesi pretendoi se ai kishte shteruar të gjitha procedurat e disponueshme të gjykatës.

16. Gjykata përsërit se ekzekutimi i një vendimi dhënë nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e “seancës dëgjimore”, sipas



parashikimit në nenin 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës së saj gjyqësore, në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shih *Hornsby kundër Greqisë*, 19 mars 1997, § 40, *Raportet e Gjyqimeve dhe vendimeve* 1997-II, dhe *Stoyanov dhe Tabakov kundër Bullgarisë* (nr. 2), nr. 64387/14, § 47, 7 dhjetor 2021).

17. Parimet e përgjithshme për shterimin e mjeteve vendase janë përmbledhur në *Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë* (kundërshtim paraprak) ([DHMI]), nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, nr. 42219/07, §§ 83–89, 9 korrik 2015).

18. Në çështjen e cituar më sipër, *Beshiri dhe të tjerë*, Gjykata vlerëson se Ligji i Pronës 2015 ishte përgatitur për të adresuar çështjen e zbatimit të së drejtës së ish-pronarëve për kompensim në një mënyrë efektive dhe kuptimplote, duke marrë në konsideratë kërkesat e Konventës, dhe se Ligji i Pronës zbatohet për të gjithë individët që paraqisnin një kërkesë pranë Gjykatës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të Pronës 2015 (shih, veçanërisht, §§ 215 dhe 217; shih edhe *Ruçi dhe Bejleri kundër Shqipërisë* (vendim) [Komiteti], nr. 56937/10 dhe 191 të tjerë, §§ 7–14 dhe 21 e në vijim, 20 prill 2021).

19. Gjykata thekson se vendimi i Gjykatës së Rrethit, i datës 16 janar 1996, njihte të drejtat e trashëguara të kërkuarit ndaj një sipërfaqe toke me përmasa 40,000 m², por nuk mbante një pozicion për formën ekzakte të rikthimit ose të kompensimit të asaj prone. Sipas parashikimeve ligjore në fuqi në atë periudhë, ish-pronarët e pronave të shpronësuar nga regjimi Komunist, ose trashëgimtarët e tyre ligjorë, kishin të drejtën për të kërkuar pronësinë e pronave fillestare. Pasi të jepej pronësia, ata kishin të drejtën që t'iu rikthehej prona e tyre fillestare e paluajtshme, ose t'iu jepej kompensim në natyrë (maksimumi 10,000 m²), ose në vlerë, nëse përmbusheshin disa kushte të caktuara (shih *Gjonbocari dhe të tjerë*, cituar më sipër, § 37). Ishte detyra e Komisionit që të verifikonte nëse këto kushte ishin përmbushur, dhe të vendoste respektivisht.

20. Gjykata kishte pranuar më herët se një pale ndërgjyqëse të suksesshme mund t'i kërkohej të ndërmerre hapa proceduralë për të kompensuar borxhin e gjykimit (shih *Shvedov kundër Rusisë*, nr. 69306/01, § 32, 20 tetor 2005). Materialet e çështjes nuk provojnë se kërkuari ka ndërmarrë hapa efektivë për të siguruar zbatimin e vendimit të

gjykatës. Veçanërisht, ai nuk kishte depozituar një kërkesë pranë Komisionit për rikthimin ose kompensimin e pronës në fjalë për 28 vite që prej vendimit të Gjykatës së Rrethit. Duke qenë se vendimi i gjykatës së brendshme nuk parashikonte një metodë për rikthimin ose kompensimin për tokë, një kërkesë e tillë do t'i kishte dhënë autoriteteve të brendshme një mundësi për të përcaktuar metodën e duhur të ekzekutimit. Duke marrë në konsideratë specifikat e legjislacionit për rikthimin e pronave, sipas së cilit kërkohej pjesëmarrja aktive e kërkuarit, paraqitja e një kërkesë ndaj Komisionit nuk përbënte një barrë të tepërt ose të paarsyeshme ndaj tij. Gjykata vlerëson se kërkuari nuk kishte paraqitur një arsye të justifikueshme për mosveprimin e tij për ta paraqitur një kërkesë të tillë.

21. Së fundmi, kërkuarit iu kërkuar, në mbështetje të nenit 35 § 1 të Konventës, që të shfrytëzonte mjetet e reja të brendshme të parashikuara në Ligjin e Pronës 2015, në përputhje me rregullat përkatëse të brendshme. Kërkuari ose nuk kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme të disponueshme, ose nuk kishte informuar Gjykatën për veprimet që mund të kishte marrë në lidhje me këtë aspekt. Gjykata nuk konstaton rrethana të jashtëzakonshme sipas së cilave kërkuarit do të përjashtoheshin nga detyrimi për të shfrytëzuar mjetet e brendshme në çështjet *Beshiri dhe të tjerë* (cituar më sipër, §§ 216–18) dhe *Ruçi dhe Bejleri* (cituar më sipër, §§ 27–28), dhe po ashtu nuk gjen arsye për t'u larguar nga ai përfundim në çështjen konkrete.

22. Sipas këtyre rrethanave, kërkesa duhet të rrëzohet sipas nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË
UNANIME, GJYKATA

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 5 shtator 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDESEKRETARE

Ioannis Ktistakis
KRYETAR



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 57941/18
NDREKAJ SHPK
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur, më 11 korrik 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësekrete e Përkohshme e Seksionit*,

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar, më 5 dhjetor 2018,

Duke mbajtur në konsideratë deklarin e bërë nga Qeveria e paditur, e cila i kërkonte Gjykatës të përjashtonte kërkesën nga lista e saj e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kompanisë kërkuese paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. Dobjani, një avokat që e ushtronte ligjin në Tiranë.

Kompania kërkuese u ankua në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin e Gjykatës së Apelit Durrës. Vendimi nr. 115, i datës 9 shkurt 2015, që urdhëronte Bashkinë Durrës t'i paguante kompanisë disa shuma të caktuara parash sipas një kontrate për punime publike iu komunikua Qeverisë Shqiptare ("Qeveria"). Ankesat e mbështetura në të njëjtat fakte u komunikuan sipas parashikimeve të tjera të Konventës.

LIGJI

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se ajo propozonte të bënte një parashtrim të njëanshëm me qëllim zgjidhjen e problematikave që kishin lindur nga këto ankesa. Gjithashtu, Qeveria i kërkoj Gjykatës të përjashtonte kërkesën në mbështetje të nenit 37 të Konventës.

Qeveria pranoi kohëzgjatjen e tepërt të procedurave ekzekutuese. Gjithashtu, ajo pranoi se

autoritetet vendase kishin shkelur të drejtat e kërkuesit të garantuara nga parashikime të tjera të Konventës.

Qeveria ofronte t'i paguante kërkuesit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur dhe fton Gjykatën të përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1 (c) të Konventës.

Në vijim, Qeveria ndërmerre të siguronte zbatimin e vendimeve të brendshme në lidhje me këtë çështje brenda periudhës tremujore, si edhe të paguante çdo kosto për procedurat e brendshme ekzekutuese.

Shuma do të konvertohej në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të shlyhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mosshlyerjes së kësaj pagese brenda periudhës tremujore të përmendur më sipër, Qeveria ndërmerre të paguante interes të thjeshtë për këtë shumë, nga përfundimi i periudhës së shlyerjes, në një normë të barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kompanisë kërkuese iu dërguan kushtet e parashtrimit të njëanshëm të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Gjykata nuk ka marrë një përgjigje nga kërkuesi ku ai të pranonte kushtet e parashtrimit.

Gjykata vëren se neni 37§1 (c) i mundëson përjashtimin e çështjes nga lista e saj, nëse:

"... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës."

Në këtë mënyrë, ajo mund të përjashtojë kërkesa mbështetur në nenin 37§1 (c) sipas parashtrimit të njëanshëm bërë nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkuesi dëshiron që të vijohet me shqyrtimin e çështjes (kundërshtimet paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat për mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve të brendshme (shih, për shembull, *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009).

Duke mbajtur në konsideratë parashtrimet në deklarinet e Qeverisë, si edhe shumën e



kompensimit të propozuar – që është në përputhje me shumat e akorduara në çështje të ngjashme – Gjykata shprehet se nuk është më e justifikueshme që të vijohet me shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 (c)).

Sipas parashtrimeve të mësipërme, Gjykata konstaton se në respektim të të drejtave të njeriut parashtruar në Konventë dhe protokollet e saj, asaj nuk i kërkohet që të vijojë me shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklarinimin e saj të njëanshëm, kërkesa mund të rikthehet në listë sipas nenit 37§2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË
MËNYRË UNANIME,

Mban në konsideratë kushtet e parashtrimit të Qeverisë së paditur dhe angazhimet për të garantuar respektimin e premtimeve të bëra në të;

Vendos të përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1 (c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 5 shtator 2024.

Viktoria Maradudina
ZËVENDËSEKRETARE
E PËRKOHSHE

Peeter Roosma
KRYETAR

SHTOJCË

*Kërkesa që paraqiti ankesa në mbështetje me nenin 6 § 1 të Konventës
(mosekzekutim ose ekzekutim i vonuar i vendimeve të brendshme)*

<i>Ankesa nr. Data e paraqitjes</i>	<i>Emri i kërkuetit Data e regjistrimit</i>	<i>Data e marrjes së deklarimit të qeverisë</i>	<i>Shuma e akorduar për dëmin jopasuror dhe për kostot dhe shpenzimet (në euro)¹</i>
57941/18 5.12.2018	NDREKAJ SHPK 1996	3.11.2023	3,600

URDHËR

Nr. 195, datë 23.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 2, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; germave “b” dhe “ç”, të nenit 13, dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 7, dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit te znj. Manjola Kelolli, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit

të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, caktuar të kryejë edhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 79, datë 10.9.2024, për të kryer procedurat dhe për të nënshkruar aktet në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për marrjen me qira të ambienteve për nevoja të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Znj. Manjola Kelolli nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM
TË APELIMIT**
Sokol Çomo

¹ Plus çdo taksë që mund t’u tarifohet kërkuësve.

**KËRKESË**

Shtetasi Dashamir Dauti kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier shpalljen të vdekur të shtetasit Shpëtim Dauti, me atësi Jakup dhe amësi Ferize, i lindur më 24.8.1972, në Fier, si dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij shtetasin Dashamir Dauti.

KËRKUES
Dashamir Dauti

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

